

V E N D I M
Nr.88, datë 1.3.1993

PËR MIRATIMIN E ZONAVE QË KANË PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT

Në zbatim të ligjit nr.7665, datë 21.1.1993 "Për zhvillimin e zonave që kanë përparësi turizmin", dhe me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Miratohen si zona që kanë përparësi zhvillimin e turizmit territoret e mëposhtme:

Në bregdet:

A. Bregdeti Adriatik

Velipoja në rrethin e Shkodrës.

- Territoret kufizuese të Gjirit të Drinit në rrethin e Lezhës.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Rodonit në rrethin e Laçit.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Lalzit në rrethin e Durrësit.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Durrësit në rrethet Durrës e Kavajë.
- Spilleja në rrethin e Kavajës.
- Territoret e Divjakës, duke përfshirë lagunën e Karavastasë në rrethin e Lushnjës.
- Territoret nga Pojani në Plazhin e Semanit në rrethin e Fierit.
- Territoret nga Pishë Poro në Zvërnec ato kufizuese të Gjirit të Vlorës.

B. Bregdeti Jon

Rrethi i Vlorës

- Gadishulli i Karaburunit.
- Plazhi i Gramës.
- Palasa.
- Dhërmiu.
- Jala.
- Himara.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Spilesë.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Palermos.
- Qeparoi.

Rrethi i Sarandës

- Borshi.
- Piqerasi.
- Lukova.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Kakomesë.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Sarandës.
- Ksamili.
- Territoret kufizuese të Gjirit të Butrintit.
- Kepi i Stillos.

Buzë liqeneve

- Bregu i Liqenit të Shkodrës, nga Zogaj deri në Koplik, në rrethet e Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe.

- Bregu i liqenit të Ohrit nga Lini në Tushemisht në rrethin e Pogradecit.
- Bregu i liqenit të Prespës nga Kallamasi në Liqenas në rrethin e Korçës.
- Bregu i liqenit të Butrintit në rrethin e Sarandës.

Zona malore

- Valbona në rrethin e Tropojës.
- Boga, Thethi, Razma në rrethin e Malësisë së Madhe.
- Shishtavec i në rrethin e Kukësit (e gjithë zona e mëshhtëknës dhe bredhit).
- Lura në rrethin e Dibrës.
- Terbuli-Livadh Kabashi në rrethin e Pukës.

- Qafështama në rrethin e Krujës.
- Mali i Dajtit në rrethin e Tiranës.
- Gjinari në rrethin e Elbasanit.
- Mali i Lenies në rrethin e Gramshit.
- Voskopoja dhe Dardha në rrethin e Korçës.
- Leskovik-Ersekë në rrethin e Kolonjës.
- Llogoraja në rrethin e Vlorës.
- Uji i Ftohtë në Tepelenë.

Terrenet e caktuara nga organet kompetente për ndërtimin e strukturave turistike në qytetet ose në qendrat që konsiderohen:

- a) Qendra turistike:
 - Durrës, Vlorë, Sarandë, Pogradec e Shëngjin.
- b) Qendra biznesi dhe transporti:
 - Tiranë, Korçë, Shkodër, Elbasan e Tepelenë.
- c) Qendra muzeale dhe historike:
 - Lezhë, Krujë, Berat e Gjirokastrë.
- ç) Turizmi kurativ:
 - Llixhat e Peshkopisë.
 - Llixhat e Bilajt (në rrethin e Krujës).
 - Llixhat e Elbasanit.
 - Llixhat e Vromoneros-Leskovik (në rrethin e Kolonjës).

2. Ngarkohet Ministria e Turizmit që, në bazë të strategjisë së zhvillimit të turizmit të përgatisë programin e hartimit të studimeve urbanistikë për zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, brenda datës 15.3.1993.

3. Ngarkohet Ministria e Ndërtimit, e Strehimit dhe Rregullimit të Territorit që, në zbatim të programit të hartuar nga Ministria e Turizmit, të organizojë punën për kryerjen e studimeve urbanistike nga institucionet shtetërore dhe private deri në përfundimin e tyre, si më poshtë:

a) Studimi dhe miratimi i vijave kufizuese mbrojtëse për zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, brenda datës 30.4.1993 (për zonat liqenore dhe kontinentale).

Për zonat bregdetare është i vlefshëm vendimi i Këshillit të Ministrave nr.321, datë 20.7.1992 "Për përcaktimin e vijës kufizuese bregdetare".

b) Studimi i gjendjes ekzistuese të zonave që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, ku pasqyrohen ndërtimet, infrastrukturën e nevojshme, tokat bujqësore, zonat e gjahut, parqet natyrore, ndotjet e mjedisit dhe burimet e mundshme të furnizimit me ujë dhe energji elektrike, si dhe hartimi i albumit deri më 31.8.1993.

c) Studimi për zonat e përmendura me sipër, duke përcaktuar sheshet dhe kapacitetet brenda datës 31.12.1993, me faza, sipas përparësive të Ministrisë së Turizmit.

4. Ngarkohen këshillat e rretheve dhe bashkitë e qyteteve, në territoret e të cilave shtrihen zonat që kanë përparësi zhvillimin e turizmit, të marrin të gjitha masat dhe t'u përgjigjen në kohë kërkesave për të dhëna ose studime, të domosdoshme për realizimin e studimeve të përmendura në pikën 3 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore t'u përgjigjen në kohën e duhur kërkesave për të dhëna ose studime, të domosdoshme për zbatimin e pikës 3 të këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Financave dhe e Ekonomisë të sigurojë fondet e nevojshme për kryerjen e studimeve paraprake.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi